# Protokoll

I mbajtur sot me datë 28.08.2024, ora 19:00 në sallën e mbledhjeve të këshillit të bashkisë me këtë rend dite:

1. Miratimi i Projektvendimit për listën e përfituesve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike i 6% për muajin Korrik 2024.

2. Miratimi i vendimit "Për fazën e parë të Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027";

3. Miratimi i vendimit "Për planin e mbarështrimit të ekonomisë pyjore Kryezi, në territorin administrativ të Bashkisë Fushë-Arrëz."

4. Projektvendimi "Për një ndryshim në vendimin nr.35, datë 29.12.2023 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2024".

5. Miratimi i propozimeve për akordimin e titullit "Qytetar Nderi i Fushë-Arrëzit".

6. Shqyrtimi i relacioneve të Komisioneve të Përkohshëm të Përzier për: rendet e ujit vaditës në fshatin Lëvoshë dhe fshatin Fushë-Arrëz, si dhe për problem rrugëkalimi në lagjen Ndokaj njësia Qendër Fushë-Arrëz, Kërkesës së Z. Gjelosh Marku për zgjidhje konflikti në lagjen Nërlymna, fshati Sapaq Njësia Administrative Iballe, për zhbllokim të një segmenti rrugë auto-rurale që lidh shtëpinë e tij me rrugën auto-rurale të lagjes Ndërlymna, shqyrtimi i kërkesës së Z. Lazer Pali Prenga fshati Kryezi Njësia Administrative Qafë-Mali

Në mbledhje morën pjesë: Kryetari i bashkisë Z. Hil Curri, Kryetari i këshillit Z. Nikolin Bardhoku, Sekretari i këshillit Z. Tom Curri, Specialistja e këshillit Zj. Vallons

Milla, përgjegjësja për çështjet sociale Zj. Fitnete Arifaj, Specialisti i pyjeve Z. Pashuk Lulashi, Përgjegjësi i financës Z. Dritan Lika.

Përveç këtyre të pranishëm janë edhe këshilltorët:

1. Vjollca Tabaku
2. Zef Cara
3. Lezina Ceca
4. Bardhok Qafa
5. Afrim Ndoj
6. Pavlin Qafa
7. Mustaf Pashkaj
8. Nikolin Bardhoku
9. Valentina Lleshaj
10. Besjana Marku
11. Lin Prendi
12. Tereze Dema
13. Franc Dada
14. Valentin Doçi
15. N. Sadiku

Mbledhja hapet nga Kryetari i Këshillit, i cili i falenderoi për pjesëmarrjen dhe lexon rendin e ditës.

Hidhet në votim: 13 vota pro
0 vota abstenim
0 vota kundër

Miratohet rendi i ditës.

Pika. 1.

F. Arifaj -> Jep shpjegime për 6%, për ndryshimet që janë bërë këtë muaj.

Hidhet në votim: 13 vota pro
0 vota kundër
0 vota abstenim.

Miratohet pika 1.

Pika 2.

D. Lika -> Prezantojmë fazën e parë të buxhetit afatmesëm. Nuk janë parashikuar ndryshime për tre vitet në vazhdim në të ardhurat vendore. Taksat dhe tarifat vendore janë të paraqitura në grafik,

dhe tabela. Planifikohet që të shkurtohen programet buxhetore. Faza e dytë që do të miratohet për projektet është faza vendimtare e këtij projekti.

Hidhet në votim 13 vota pro
0 vota kundër
0 vota abstenim

Miratohet pika 2.

Pika 4.

D. Lika -> Kemi parashikuar investimin prej 400 mijë lekësh për një kondicioner për bashkinë, ku temperaturat janë të larta.

Hidhet në votim: 13 vota pro
0 vota kundër
0 vota abstenim

Miratohet pika 4.

Pika 3.

A. Dada -> Kemi një plan të ri funksional i bazuar në ligj. Bashkia ka 19 ekonomi pyjore. 2754 ha ku përfshihen tre fshatra, shpresojmë se do të shtrihet në gjithë territorin.

Bardhoku -> Ky plan duhet të jetë për të gjitha njësitë jo vetëm për kryezin. Duhet të shpallen zona ekonomike

H. Curri -> Plani është i detajuar, është tenderuar me një shumë të vogël 30. milion të vjetra. Ministria na ka premtuar se do të na ndihmojë me fonde.

Bardhoku -> Ne krijojmë premisat për investime. Në fund firmos kryeministri, është një proçes i gjatë, i cili është miratuar në këshillin e mandatit të kaluar.

Lin Prendi -> Ka shumë turista në Dardhë dhe nuk ka investime, s'ka rrugë të asfaltuara. Është turp.

Hidhet në votim 15 vota pro
0 vota kundër
0 vota abstenim.

Miratohet pika 3.

N. Bardhoku -> çdo territor duhet të jetë i zhvilluar, dhe do bëjmë të jetë e mundur për zhvillimin e çdo fshati

Pika 5.

T. Curri -> Janë tre emra të njohur, të cilët kanë luftuar për trojet Shqipetare, Komiteti keshillimor e ka miratuar. Të tre janë nga Berisha, kanë marrë pjesë në luftën e Qelzës, janë nga i njëjti fis i Berishës.
N. Bardhoku -> këto kanë jetuar përpara '45 dhe nuk kanë qenë bashkëpunëtor me sigurimin e shtetit. Propozimi është bërë në bazë të shkrimeve për to, sepse nuk kemi njohje. Kemi tre muaj që e kemi shtyrë, që të mos veprojmë pa u munduar.

Hidhet në votim Dedosh Jaku -> 15 vota pro
0 vota kundër
0 vota abstenim

Ndrek Markiçi 15 vota pro
0 vota kundër
0 vota abstenim

Ndue Dashi 15 vota pro
0 vota kundër
0 vota abstenim.

Miratohet pika 5.

N. Bardhoku -> Janë 3 lagje në konflikt në kryezi për rendin vaditës. Janë disa kopa që duhen të ndiqen deri kur vinë tek keshilli. Rendet e vadës

janë ndarë fshatçe.
H. Kola -> Ka vendim Këshilli të komunës Rajo-Mali, i cili ndryshet vetëm në gjykatë, s'kemi pse ta diskutojmë k...
Dod Markadoda -> Janë dy vija që përplasen me njëra tjetrën. Zef Kolës i kam kërkuar të zgjidhet ky prb., i cili ra dakort dhe votuan lagjja. Kam toke më shumë se të gjithë, dhe kjo marrëveshje është firmosur nga të gjithë, 17 pro dhe 3 kundër është votuar.
Mark Pali -> Kërkoj që bëhet sikur ka qenë në kohën e babait tim dhe baballarëve tuaj, nuk kërkoj më tepër
Doda -> Nuk kam fituar asgjë, as nuk kam vjedhur.
T. Lleshi -> Kryesia e këshillit ka marrë disa masa. Kjo problematik ka lindur, sepse njerëzit nuk mba... mend rendet e ~~këshillit~~ ujit dhe ky është problem i madh.
H. Kola -> Nuk ka shtuar asnjë ditë uji. Kemi një vendim
N. Mejdani -> Është problem mes kushërinjve, se marrin ujë prej inatit të njëri tjetrit. Po shesin rendet e ujit me lek. dhe neve na ndalohet vada. Duhet të jemi njëse...
N. Bardhoku -> Të krijohet një komision me anëtarë, kr. i fshatit, Administratori, një këshilltar dhe Sajmir Lleshi
Hil Kola: Që të mbyllet kjo histori është investuar 30 mi... lekë, rentarët kanë votuar. Nuk mund të merret vendi... sepse është një vendim, vetëm në gjykatë zgjidhet.
A. Ndoj -> Janë probleme individuale dhe nuk mund të ndërhyjmë. Ka një dokumentacion përkatës.
Ndoci: Rendi është një herë në 9 ditë, pse duhet të kalojë një herë në 13 ditë. Pse të mos kemi ujë të gjithë njësoj. Do të bëhet problem i madh mes nesh.

H. Curri -> Është marrë në shqyrtim dhe kjo si shumë probleme të tjera që kanë pasur nga 15 vite me probleme dhe janë zgjidhur. Të ngrihet një komision.
H. Kola -> Kërkohet veç ndryshimi i rendeve. Do të sjell dokumentacionin. Një ka mjaftueshëm, nuk kërkojmë
Ndrek Çuku -> Për 3 persona nuk lëvizim rendin e njit të 30 familjeve të tjera. Janë dy vendime një në 2011 dhe një në 2014. Kështu kanë rënë dakort atë vite për rendet.

Hidhet në votim ngritja e komisionit! 15 vota pro
0 vota kundër
0 vota abstenim

Miratohet ngritja e komisionit
T. Curri -> Është problem për një rrugë, ku është ngritur një komision dhe ka shkuar verifikuar në terren.
Lexon relacion Kryetari i këshillit.
Franci -> Rruga është e hapur, kemi shkuar dhe verifikuar. Janë të gjithë banorët kanë deklaruar se ka qenë rrugë egzistuese. Si të veprojmë përderisa është e hap
Deda -> Nuk na lejon të kalojmë, nuk e ka bllokuar.
Sajmici -> Është rrugë shtet, nga verifikimi nuk na rezulton e bllokuar. Rruga është shtet pa pronar, por në administrim të bashkisë.
N. Bardhoku -> Rruga është e hapur dhe palët paditëse duhet të drejtohen drejt organeve kompetente.
Hidhet në votim. 15 vota pro
0 vota kundër
0 vota abstenim.
Problemi për ndërhyrjen e paraqitur nga Lazer Pali, nuk është kopetente ajo, gjithashtu Lazri nuk është i pranishëm

N. Bardhoku -> Vazhdon problemi në Nërlymë.
B. Qafa -> Kemi qenë dhe kemi bërë verifikime por pak s'zgjidhen. Duhet të zgjidhet, duke rënë dakord.
Bardhoku -> Të negociohet me grupin B. Qafa, Afrim, Lini Tonin Prenga, Sajmir Lloshi dhe dy palët në konflikt.

Hidhet votim: 15 pro, o kundër, o abstenim.

Vjollca -> Për problemin në Lëvoshë, nuk ka diçka serioze thjesht dikush do të ndryshojë rendin e ujit. N. Bardhoku lexon shkresën e dërguar nga Kr. i fshatit Lëvoshë. Ndarja do të jetë në mënyrë zakonore, mes familjeve kështu është vendosur.

Hidhet në votim: 15 vota pro, o vota kundër, o vota

Lek Curri: Vëllezërit janë kthyer dhe kanë marrë rendin e vet. N. Bardhoku -> Komisioni i ngritur bashkë me kryesinë të bëjnë verifikimin e rendeve në periudhën para vitit '92.

Mbledhja mbyllet!

Nikolin Bardhoku
Bardhok Qafa
Lezina Ceca
Lin Prendi
Mustaf Pashkaj
Zef Coca
Vjolca Tabaku
Valentina Lleshaj
Tereze Dema
Valentin Doçi
Pavlin Qafa
Afrim Ndoj
Franç Doda
Nikolin Sadiku

Besjana Marku

Mbajti Protokollin
Vallona Milla

Sekretari
Tom Curri